



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2962/9 prot

Datë 27.12.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1365/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.12.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur*” me mjete elektronike” me nr. REF-77341-08-11-2023 me objekt: “*Shërbim për monitorimin e mjedisit*”, me fond limit 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 07.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.
- Ankimues:** “TENUIS LABORATORIES” SHPK me NIPT L81904506I dhe me adresë, Rruga dytësore Maminas-Vorë, Nr 20/38, Koxhas.
- Autoriteti Kontraktor:** Albpetrol sh.a. me adresë Lagjja “29 Marsi” Patos, Selia Rruga Fier – Patos, km 7.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.08.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me mjete elektronike” me nr. REF-77341-08-11-2023 me objekt: “Shërbim për monitorimin e mjedisit”, me fond limit 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e

*gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë*) lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 07.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol Sh.A.

II.2. Në datën 07.11.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 15.11.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH, si më poshtë:

1. “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK 7,811,869.74 Lekë kualifikuar
2. “QENDRA E MONITORIMIT TE MJEDISIT” SHPK 11,779,092.00 Lekë skualifikuar
3. “TENUIS LABORATORIES” SHPK 10,189,500.00 Lekë skualifikuar

II.4. Në datën 23.11.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit” për procedurën e prokurimit të sipërcituar, si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 96, datë 30.11.2023.

II.5. Në datën 29.11.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3650 dhe protokolluar me nr. 2962/2023 prot., datë 30.11.2023 e operatorit ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK. Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se kësaj të fundit i mungon dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2962/2 prot., datë 01.12.2023.

II.7. Me anë të shkresës nr.10003 prot., datë 01.12.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.2962/3 prot., datë 04.12.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku ndër të tjera informon: “[...] *...Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se mandat pagesa për ankesën e datës 29.11.2023 e cila shoqëron formularin e ankesës është e njëjta me dokumentin bankar të lëshuar për ankesën e datës 21.11.2023, ankesë e cila është shqyrtuar nga autoriteti kontraktor dhe iu është kthyer*

*përgjigje. Pra rezulton se, për këtë ankesë ju nuk keni paraqitur dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Për sa më sipër, dhe në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 111 dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 94, pika 4, **kërkojmë që brenda dy ditëve nga marrja e këtij njoftimi të paraqisni dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën, në të kundërt ankesa do të konsiderohet si e paparaqitur...**”.*

II.8. Operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresën me nr. 60 prot., në datën 04.12.2023, e protokolluar me tonën me nr. 2962/4 prot., datë 05.12.2023, ku informon: “Pranë shoqërisë tonë erdhi me email shkresa juaj me nr. 10003 prot., datë 01.12.2023 me lëndë “kërkesë për paraqitjen e dokumentit bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën”. Bazuar në nenin 97 Njoftim Fituesi të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku citohet se: “1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji”.

*Vlerësimi i ofertave nga AK është bërë në datë 15.11.2023 dhe shpallja fitues në datë 23.11.2023 duke shkelur afatet e nenit të sipërpërmendur. Duke qenë se me prokurimet publike u bë një kohë e gjatë që aplikojmë dhe ndonjëherë Ak nuk publikojnë sms në faqet e APP-së për fillimin e ankimit, ne si Tenius Laboratories bëmë aplikimin në datë 21.11.2023 për të mos humbur afatet nga publikimi i ofertave bazuar edhe në nenin 109 dhe 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Më pas në datë 23.11.2023 erdhi sms për njoftimin e fillimit të ankimit dhe ne bëmë riaplikim të të njëjtit ankimim sëbashku me pagesën përkatëse për të qenë brenda afateve të përcaktuara në nenin 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me interes për AK dhe KPP është pagesa e cila nga ana jonë është kryer dhe një kopje ua kemi bashkëngjitur, por gjithashtu me interes është dhe një procedurë prokurimi e drejtë dhe e lejon konkurrencën e lirë dhe sigurimin e shërbimit që ju kërkoni”.*

II.9. Referuar sa më sipër, me anë të shkresës nr. 2962/5 prot., datë 19.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i dha mundësi operatorit ekonomik ankimues, se në rast se nuk kishte marrë dijeni për njoftimin mbi plotësimin e të metave të ankesës së tij, ti plotësonte ato, konkretisht: “...kërkon nga ana juaj të vërtetohet me dokumentacion provues pagesa e kryer për ankesën e bërë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe protokolluar me nr. 2962 prot., datë 30.11.2023 për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur” me mjete elektronike” me nr. REF-77341-08-11-2023 me objekt: “Shërbim për monitorimin e mjedisit”, me fond limit 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 07.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a. Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për

*prokurimin publik” dhe ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon nga ana juaj, dërgimin e informacionit të kërkuar për sa më lart, brenda datës 21.12.2023, ora 09:00”.*

II.10. Operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresën me nr. 64 prot., në datën 25.12.2023, e protokolluar me tonën me nr. 2962/6 prot., datë 26.12.2023, ku informon: *“Pranë shoqërisë tonë erdhi me postë shkresa me nr. 2962/5 prot., datë 19.12.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion” në datën 22.12.2023 sipas dokumentacionit bashkëlidhur. në këtë shkresë, KPP kërkon nga ana jonë të vërtetohet me dokumentacionin provues pagesa e kryer për ankesën elektronike me nr. 2962 prot., datë 30.11.2023 për procedurën me REF-77341-08-11-2023 me objekt: “Shërbim për monitorimin e mjedisit”, brenda datës 21.12.2023. Duke qënë se shkresa me anë të postës erdhi në datë 22.12.2023, ju bëjmë me dije se me anë të shkresës nr. 60 prot., datë 04.12.2023 me lëndë “Kthim përgjigje për shkresën nr.10003 prot., datë 01.12.2023” ne kemi informuar AK si dhe KPP me anë të email dhe postës si më poshtë vijon: Bazuar në nenin 97 Njoftim Fituesi të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku citohet se: “1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji”. Vlerësimi i ofertave nga AK është bërë në datë 15.11.2023 dhe shpallja fitues në datë 23.11.2023 duke shkelur afatet e nenit të sipërpërmendur. Duke qënë se me prokurimet publike u bë një kohë e gjatë që aplikojmë dhe ndonjëherë Ak nuk publikojnë sms në faqet e APP-së për fillimin e ankimit, ne si Tenius Laboratories bëmë aplikimin në datë 21.11.2023 për të mos humbur afatet nga publikimi i ofertave bazuar edhe në nenin 109 dhe 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Më pas në datë 23.11.2023 erdhi sms për njoftimin e fillimit të ankimit dhe ne bëmë riaplikim të të njëjtit ankimim sëbashku me pagesën përkatëse për të qënë brenda afateve të përcaktuara në nenin 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.....Duke qënë se:*

*1.Ishte i njëjti ankimim “mot a mot”si ankimimii parë, por e dërguar në respekt të procedurave të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”*

*2.Autoriteti Kontraktor, në shkelje të Ligjit 162/2020, e ka shpallur jashtë afateve ligjore prej 5 ditësh.*

*Do kërkonim që pagesa e bërë në datën 21/11/2023 ti kalojë ankimit tonë të datës 30.11.2023. Me interes për AK dhe KPP është pagesa e cila nga ana jonë është kryer dhe një kopje ua kemi bashkëngjitur, por gjithashtu me interes është dhe një procedurë prokurimi e drejtë dhe që lejon konkurrencën e lirë dhe sigurimin e shërbimit që ju kërkon. Pra në thelb është e njëjta ankesë dhe brenda afateve dhe ju ftojmë të merrni në konsideratë aplikimin tonë dhe presim një përgjigje sa më shpejt të jetë e mundur”.*

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar që të vërtetojë, se ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III.1.1. Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.*

*Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

*2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

*3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.*

*4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”*

III.1.2. Në pikën 2 gërma “a”, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

*“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

*a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;”*

III.1.3. Në datën 29.11.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3650 dhe protokolluar me nr. 2962/2023 prot., datë 30.11.2023 e operatorit ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se mandat pagesa për ankesën e datës 29.11.2023 e cila shoqëron formularin e ankesës është e njëjta me dokumentin bankar të lëshuar për ankesën e datës 21.11.2023, ankesë e cila është shqyrtuar nga autoriteti kontraktor si dhe KPP, me vendimin KPP 1250/2023, datë 05.12.2023. Pra, kësaj të fundit i mungon dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur, protokolluar me nr. 2962/2023 prot., datë 30.11.2023.

III.1.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2962/2 prot., datë 01.12.2023.

III.1.5. Me anë të shkresës nr.10003 prot., datë 01.12.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.2962/3 prot., datë 04.12.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku ndër të tjera informon: “[...] ...Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se mandat pagesa për ankesën e datës 29.11.2023 e cila shoqëron formularin e ankesës është e njëjta me dokumentin bankar të lëshuar për ankesën e datës 21.11.2023, ankesë e cila është shqyrtuar nga autoriteti kontraktor dhe iu është kthyer përgjigje. Pra rezulton se, për këtë ankesë ju nuk keni paraqitur dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Për sa më sipër, dhe në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 111 dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 94, pika 4, **kërkojmë që brenda dy ditëve nga marrja e këtij njoftimi të paraqisni dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën, në të kundërt ankesa do të konsiderohet si e paparaqitur...**”.

III.1.6. Operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresën me nr. 60 prot., në datën 04.12.2023, e protokolluar me tonën me nr. 2962/4 prot., datë 05.12.2023, ku informon: “Pranë shoqërisë tonë erdhi me email shkresa juaj me nr. 10003 prot., datë 01.12.2023 me lëndë “kërkesë për paraqitjen e dokumentit bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën”. Bazuar në nenin 97 Njoftim Fituesi të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku citohet se: “1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit

elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji”.

Vlerësimi i ofertave nga AK është bërë në datë 15.11.2023 dhe shpallja fitues në datë 23.11.2023 duke shkelur afatet e nenit të sipërpërmendur. Duke qenë se me prokurimet publike u bë një kohë e gjatë që aplikojmë dhe ndonjëherë Ak nuk publikojnë sms në faqet e APP-së për fillimin e ankimit, ne si Tenius Laboratories bëmë aplikimin në datë 21.11.2023 për të mos humbur afatet nga publikimi i ofertave bazuar edhe në nenin 109 dhe 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Më pas në datë 23.11.2023 erdhi sms për njoftimin e fillimit të ankimit dhe ne bëmë riaplikim të të njëjtit ankimim sëbashku me pagesën përkatëse për të qenë brenda afateve të përcaktuara në nenin 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me interes për AK dhe KPP është pagesa e cila nga ana jonë është kryer dhe një kopje ua kemi bashkëngjitur, por gjithashtu me interes është dhe një procedurë prokurimi e drejtë dhe e lejon konkurrencën e lirë dhe sigurimin e shërbimit që ju kërkoni”.

III.1.7. Referuar sa më sipër, me anë të shkresës nr. 2962/5 prot., datë 19.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i dha mundësi operatorit ekonomik ankimues, se në rast se nuk kishte marrë dijeni për njoftimin mbi plotësimin e të metave të ankesës së tij, ti plotësonte ato, konkretisht: “...kërkon nga ana juaj të vërtetohet me dokumentacion provues pagesa e kryer për ankesën e bërë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe protokolluar me nr. 2962 prot., datë 30.11.2023 për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur” me mjete elektronike” me nr. REF-77341-08-11-2023 me objekt: “Shërbim për monitorimin e mjedisit”, me fond limit 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 07.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a. Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon nga ana juaj, dërgimin e informacionit të kërkuar për sa më lart, brenda datës 21.12.2023”.

III.1.8. Operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresën me nr. 64 prot., në datën 25.12.2023, e protokolluar me tonën me nr. 2962/6 prot., datë 26.12.2023, ku informon: “Pranë shoqërisë tonë erdhi me postë shkresa me nr. 2962/5 prot., datë 19.12.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion” në datën 22.12.2023 sipas dokumentacionit bashkëlidhur. në këtë shkresë, KPP kërkon nga ana jonë të vërtetohet me dokumentacionin provues pagesa e kryer për ankesën elektronike me nr. 2962 prot., datë 30.11.2023 për procedurën me REF-77341-08-11-2023 me objekt: “Shërbim për monitorimin e mjedisit”, brenda datës 21.12.2023. Duke qenë se shkresa me anë të postës erdhi në datë 22.12.2023, ju bëjmë me dije se me anë të shkresës nr. 60 prot., datë 04.12.2023 me lëndë “Kthim përgjigje për shkresën nr.10003 prot., datë 01.12.2023” ne kemi informuar AK si dhe KPP me anë të email



dhe postës si më poshtë vijon: Bazuar në nenin 97 Njoftim Fituesi të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku citohet se: “1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji”. Vlerësimi i ofertave nga AK është bërë në datë 15.11.2023 dhe shpallja fitues në datë 23.11.2023 duke shkelur afatet e nenit të sipërpërmendur. Duke qenë se me prokurimet publike u bë një kohë e gjatë që aplikojmë dhe ndonjëherë Ak nuk publikojnë sms në faqet e APP-së për fillimin e ankimimit, ne si Tenius Laboratories bëmë aplikimin në datë 21.11.2023 për të mos humbur afatet nga publikimi i ofertave bazuar edhe në nenin 109 dhe 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Më pas në datë 23.11.2023 erdhi sms për njoftimin e fillimit të ankimimit dhe ne bëmë riaplikim të të njëjtit ankimim sëbashku me pagesën përkatëse për të qenë brenda afateve të përcaktuara në nenin 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.....Duke qenë se:

1. Ishte i njëjti ankimim “mot a mot” si ankimimii parë, por e dërguarnë respekt të procedurave të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”

2. Autoriteti Kontraktor, në shkelje të Ligjit 162/2020, e ka shpallur jashtë afateve ligjore prej 5 ditësh.

Do kërkonim që pagesa e bërë në datën 21/11/2023 ti kalojë ankimimit tonë të datës 30.11.2023. Me interes për AK dhe KPP është pagesa e cila nga ana jonë është kryer dhe një kopje ua kemi bashkëngjitur, por gjithashtu me interes është dhe një procedurë prokurimi e drejtë dhe që lejon konkurrencën e lirë dhe sigurimin e shërbimit që ju kërkon. Pra në thelb është e njëjta ankesë dhe brenda afateve dhe ju ftojme të merrni në konsideratë aplikimin tonë dhe presim një përgjigje sa më shpejt të jetë e mundur”.

III.1.9. Referuar pikës 2, të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2, të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet

të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës nr. 10003 prot., datë 01.12.2023, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.2962/3 prot., datë 04.12.2023 rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3, të nenit 111 të LPP-së, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes shkresës sësipërcituar, konstatohet se autoriteti kontraktor, ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues për ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllim shqyrtimin e saktë të të gjitha fakteve dhe rrethanave, me anë të shkresës nr.2962/5 prot., datë 19.12.2023, iu drejtua operatorit ekonomik ankimues duke i kërkuar që të vërtetonte nëse kishte marrë dijeni në lidhje me njoftimin e autoritetit kontraktor për plotësimin e të metave dhe nëse jo, plotësimin e tyre brenda datës 21.12.2023, pra Komisioni i Prokurimit Publik i ka lënë mundësi operatorit ekonomik ankimues për plotësimin e të metave deri në datë 21.12.2023, por ky i fundit përsëri nuk vërteton se ka kryer pagesën e tarifës.

Në shkresën me nr. 64 prot., në datën 25.12.2023, e protokolluar me tonën me nr. 2962/6 prot., datë 26.12.2023, ku informon ndër të tjera se.... ”.....*Duke qënë se:*

*1. Ishte i njëjti ankimim “mot a mot” si ankimimii parë, por e dërguar në respekt të procedurave të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”*

*2. Autoriteti Kontraktor, në shkelje të Ligjit 162/2020, e ka shpallur jashtë afateve ligjore prej 5 ditësh.*

*Do kërkonim që pagesa e bërë në datën 21/11/2023 ti kalojë ankimimit tonë të datës 30.11.2023.*

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues përmes njoftimit me shkresë, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, i dha mundësinë operatorit ekonomik ankimues, që në rast se nuk kishte marrë dijeni nga autoriteti kontraktor për plotësimin e të metave, të mund të

plotësonte këto të meta deri në datë 21.12.2023, por operatori ekonomik ankimues, dështoi në plotësimin e tyre.

Gjithashtu, është kryer verifikimi dhe në protokollin e institucionit të KPP-së, nëse është kthyer shkresa nga shërbimi postar, dhe është konfirmuar që nuk ka kthim mbrapsht të asnjë zarfi nga shërbimi postar drejtuar operatorit ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK.

Pra, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se mandat pagesa për ankesën e datës 29.11.2023 e cila shoqëron formularin e ankesës është e njëjta me dokumentin bankar të lëshuar për ankesën e datës 21.11.2023 për të njëjtën procedurë prokurimi por për këtë të fundit, Komisioni është shprehur me vendimin KPP 1250/2023, datë 05.12.2023.

Si përfundim, për ankesën e datës 29.11.2023 të kryer nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, i mungon dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur dhe e protokolluar me nr. 2962/2023 prot., datë 30.11.2023.

III.1.10. Në këto kushte Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk është privuar nga mundësia që i jep ligji për të korrigjuar një prej elementeve formale të domosdoshme. Fakti që nuk ka korrigjuar të metat e ankesës, si në rastin konkret pagimin e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit.

Referuar arsytimit, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës si dhe ka refuzuar ndreqjen e të metave sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni gjykon, se ankesa operatorit ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a”, të pikës 2, të nenit 118, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me mjete elektronike” me nr. REF-77341-08-11-2023 me objekt: “*Shërbim për monitorimin e mjedisit*”, me fond limit 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 07.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol Sh.A.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova

### Kryetar

**Jonaid Myzyri**

